



Prishtinë, 07 maj 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3216_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Mbështetur në Nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 47, Nenin 48 dhe Nenin 49 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), Dispozitat e Nenit 37 dhe Nenit 38 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085), Rregullën ZRRE/Nr.15/2017 për vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU), Metodologjinë për Strukturën Tarifore sipas Nenit 20 të Rregullës ZRRE/Nr. 15/2017 për të Hyrat e FSHU, Vendimin V_3213_2026 të datës 05 maj 2026 për aprovimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbim Universal (FSHU), Vendimin V_3214_2026 të datës 07 maj 2026 për aprovimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit, Operimit të Sistemit dhe Operimit të Tregut, Vendimin V_3215_2026 të datës 07 maj 2026 për aprovimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Propozimin e Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU), për Tarifat e Furnizuesit me Shërbim Universal, të dërguar më datë 6 maj 2026 në ZRRE,

në seancën e mbajtur më 07 maj 2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - Tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, që do të mblidhen nga data 01 maj 2026 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.
- II. Tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, që do të zbatohet nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU), janë paraqitur në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:



Tabela: Tarifat me pakicë të Energjisë Elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal për vitin 2026:

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë	Tarifa
1	35 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		14.54
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		7.61
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.40
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.11
	Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.87	
2	10 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		6.00
		Fuqia e angazhuar	€/kW		6.56
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.44
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.80
	Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.87	
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët me energji reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.34
		Fuqia e angazhuar	€/kW		3.87
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	8.70
			€/kWh	Tarifë e Ulët	6.46
	Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.87	
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.87
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	11.47
			€/kWh	Tarifë e Lartë	13.92
			€/kWh	Tarifë e Ulët	6.90
5	0.4kV matësi 2 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.32
		0-800kWh (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifë e Lartë	9.05
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.88
		>800kWh (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifë e Lartë	15.43
			€/kWh	Tarifë e Ulët	7.28
6	0.4kV matësi 1 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.32
		0-800 (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifë e vetme	7.12
		>800 (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifë e vetme	12.39
7	0.4kV (familjarë pa matës)	Konsumi i vlerësuar:			
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.32
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë mesatare	9.05
8	Ndriçimi Publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.17
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	12.01

Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1 tetor deri më 31 mars
 Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1 prill deri më 30 shtator
 Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korespondon me $\cos(\Phi) < 0.95$

III. Ky vendim do të zbatohet nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU), nga data 01 maj 2026 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm: ZRRE) më datë 20 dhjetor 2025 ka iniciuar procesin: Azhurnimet Vjetore të të Hyrave dhe Tarifave për Operatorët e Rregulluar duke përfshirë edhe Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU).
- ZRRE sipas dokumentit iniciues dhe njoftimit publik ka vlerësuar se ky proces i Azhurnimeve vjetore të të hyrave dhe tarifave për vitin relevant tarifor 2026, ka për qëllim që të siguroj që të



Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për të licencuarit e rregulluar të jenë në përputhje dhe në pajtueshmëri me kostot reale dhe parashikimet për periudhën tarifore.

- ZRRE ka njoftuar se në pajtim me Rregullat e të Hyrave për të Licencuarit, parashikimet duhet azhurnuar për të marr parasysh dallimet nëpërmjet vlerave të parashikuara ndaj atyre të realizuara. Pra, përshtatjet barten në vitin vijues, apo dallimet e vitit t-1 barten në vitin "t" në kuadër të procesit relevant tarifor. Po ashtu ka theksuar se pas mbledhjes së të dhënave relevante nga të licencuarit, do të analizoj dhe vlerësoj aplikacionet e të licencuarve për të përcaktuar kostot reale që reflektohen në tarifatat përkatëse.
- ZRRE përmes njoftimit ka theksuar se, ashtu siç është e përcaktuar në Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE ka mandat të përcaktojë të hyrat e lejuara maksimale dhe tarifatat për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesin me Shërbim Universal. Tarifatat e energjisë elektrike me pakicë për Furnizuesin me Shërbim Universal përcaktohen vetëm për konsumatorët që e gëzojnë të drejtën e shërbimit universal. ZRRE konform vendimit të Gjykatës Supreme dhe zbatimit të Ligjit për Energjinë Elektrike në frymën e Direktivës 2009/72/EC të interpretuar edhe nga Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit, thekson se konsumatorët të cilët e gëzojnë të drejtën e shërbimit universal janë konsumatorët të cilët në mënyrë kumulative i plotësojnë të dy kriteret e shërbimit universal, e ku përfshihen të gjithë konsumatorët familjarë dhe, kur e shohin të përshtatshme, ndërmarrjet e vogla (ndërmarrje me më pak se 50 punonjës dhe një qarkullim vjetor ose bilanc jo më shumë se 10 milion EUR).
- ZRRE ka kërkuar nga FSHU që në kuadër të përgatitjes së aplikimeve tarifore dhe dokumenteve përcjellëse, ka obligim që të marrë në konsideratë këtë vlerësim të ZRRE-së, së bashku me interpretimin detyrues të Gjykatës Supreme, si bazë për zbatimin korrekt dhe të plotë të kriterëve kumulative për shërbimin universal. Në vijim të këtij vlerësimi, kërkohet që FSHU të reflektojë në aplikimet e ardhshme tarifore këtë interpretim të Gjykatës Supreme, në përputhje me kërkesat ligjore dhe me standardet e zbatimit të shërbimit universal.
- ZRRE, po ashtu përmes njoftimit ka theksuar se, do të publikojë aplikacionet sapo të vlerësohen si të kompletuara dhe siguron palët e interesit që vendimet përfundimtare do të marrin parasysh të dhënat relevante dhe komentet e tyre.
- Gjatë procesit të shqyrtimit të aplikacionit për të hyrat e lejuara maksimale, në kuadër të procesit të shqyrtimit të aplikimit dhe sqarimeve të mëtejshme, ZRRE nëpërmjet korrespondencave të vazhdueshme, ka kërkuar nga FSHU dhënien e informacionit, përditësimin e të dhënave, argumenteve dhe dokumentacionit justifikues lidhur me të gjitha çështjet e evidentuara në mënyrë që të kemi transparencë për marrjen e një vendimi të drejtë e kosto reflektues të tarifave.
- ZRRE me datë 28 janar 2026 ka pranuar aplikacionin nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU), ka pranuar aplikacionin për azhurnimet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2026, duke paraqitur të dhënat e realizuara për vitin 2025 dhe kërkesat për vitin 2026.
- FSHU në aplikacionin e saj për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin tarifor 2026, ka propozuar që të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2026 të jenë në shumën prej 528.779 milion €. Në kuadër të aplikacionit, FSHU ka paraqitur vlerësimet lidhur me kostot e lejuara me



pakicë, kostot e blerjes së energjisë me shumicë, kostot e bartshme nga OST/OT dhe OSSH, kostot e fondit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), marzhën me pakicë, lejimin për borxhin e keq, kapitalin punues dhe Faktori i përshtatjes së të hyrave (ADJt), duke argumentuar se këto kosto janë të nevojshme për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të pandërprerë me energji elektrike për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal.

- ZRRE gjatë shqyrtimit të aplikacionit të FSHU-së, ka zhvilluar një proces të detajuar të verifikimit dhe validimit të të dhënave të paraqitura nga i licencuari, duke përfshirë analizimin e Bilancit të përditësuar të Energjisë Elektrike, zhvillimet në disponueshmërinë e kapaciteteve gjeneruese vendore, ndikimin e rehabilitimit të njërive të TC Kosova A dhe TC Kosova B, kostot e importit të energjisë elektrike dhe ndikimin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në strukturën e konsumatorëve të furnizuar nga FSHU.
- ZRRE ka vlerësuar se përcaktimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal duhet të reflektojë vetëm kostot reale, të arsyeshme dhe të justifikueshme që lidhen me furnizimin e konsumatorëve të cilët gëzojnë të drejtën e shërbimit universal. ZRRE ka theksuar se tarifat e energjisë elektrike për FSHU përcaktohen vetëm për konsumatorët që përmbushin kriteret ligjore të shërbimit universal, në pajtim me Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe interpretimin detyrues të Gjykatës Supreme lidhur me kriterin kumulativ të konsumatorëve që kanë të drejtë në furnizim universal.
- ZRRE më datë 10 prill 2026 ka publikuar Raportin Konsultativ për Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbimit Universal për vitin relevant tarifor 2026, në të cilin janë paraqitur propozimet fillestare të ZRRE-së, lidhur me komponentët e kostove të FSHU-së, që ndikojnë në përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale. Raporti Konsultativ ka trajtuar kostot e lejuara me pakicë përfshijnë kostot operative dhe të mirëmbajtjes, kostot e korporatës, kostot e zhvlerësimit, marzhën me pakicë, kapitalin punues dhe komponentët tjerë relevantë që lidhen drejtpërdrejt me furnizimin e konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal.
- ZRRE, sa i përket kostove të lejuara me pakicë, ka vlerësuar se ato përfshijnë kostot që lidhen me furnizimin e konsumatorëve të rregulluar, duke përfshirë kostot operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX), kostot korporative, kostot e zhvlerësimit dhe kostot tjera që janë jashtë kontrollit të Furnizuesit me Shërbim Universal. ZRRE në Raportin Konsultativ ka propozuar një lejim të kostove me pakicë për vitin 2026 në shumën prej 8.354 milion.
- ZRRE gjatë shqyrtimit të aplikacionit të FSHU-së ka analizuar kostot operative dhe të mirëmbajtjes, duke marrë në konsideratë vlerat hyrëse të aprovuara për FSHU në kuadër të periudhës rregullative 2025–2027, indeksimin e inflacionit dhe faktorët e efikasitetit të aplikueshëm sipas metodologjisë rregullatore në fuqi. ZRRE ka reduktuar kostot operative të propozuara nga FSHU nga 10.29 milion € në 8.19 milion €, duke reflektuar vlerësimin për efikasitetin dhe arsyeshmërinë e kostove operative. Gjithashtu, kostot e zhvlerësimit për vitin 2026 janë vlerësuar në shumën prej 0.137 milion €, të indeksuara me normën e inflacionit prej 2.13%, ndërsa kërkesat shtesë investive të FSHU-së nuk janë pranuar në tërësi për qëllime tarifore për shkak të mungesës së analizës së ndikimit të procesit të de-rregullimit në këto investime.
- Komponentët tjerë të kostove me pakicë, përkatësisht marzha me pakicë, lejimi për borxhin e keq dhe kapitali punues, janë kalkuluar nga ZRRE në përputhje me formulat dhe metodologjinë e përcaktuar në Rregullën për të Hyrat e FSHU-së. ZRRE në Raportin Konsultativ ka propozuar



marzhën me pakicë në shumën prej 4.4 milion €, lejimin për borxhin e keq në shumën prej 7.322 milion € dhe lejimet e kapitalit punues në shumën prej 2.685 milion €, duke reflektuar vetëm kostot reale, të arsyeshme dhe të justifikueshme për operimin e Furnizuesit me Shërbim Universal.

- ZRRE sa u përket kostove të bartshme të FSHU-së, ka vlerësuar se këto kosto varen nga të Hyrat e Lejuara Maksimale të aprovuara për operatorët tjerë të rregulluar dhe më pas barten në kalkulimin e HLM-së, së FSHU-së, vetëm për pjesën e konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit universal. Në këtë drejtim, kostot e bartshme për OST/OT janë propozuar në shumën prej 32.36 milion €, kostot e bartshme të OSSH-së në shumën prej 157.47 milion €, ndërsa kostot për Fondin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë në shumën prej 8.08 milion €. ZRRE ka vlerësuar se këto kosto duhet të reflektojnë vetëm vlerat e aprovuara në kuadër të vendimeve përkatëse tarifore për operatorët e rregulluar dhe vëllimet e energjisë së furnizuar për konsumatorët e rregulluar nga FSHU.
- ZRRE gjatë vlerësimit të kostove të blerjes së energjisë me shumicë ka marrë në konsideratë Bilancin e përditësuar të Energjisë Elektrike, zhvillimet në prodhimin vendor, rehabilitimin e planifikuar të njësive të Termocentralit Kosova A dhe Kosova B gjatë vitit 2026, si dhe ndikimin e këtyre zhvillimeve në rritjen e importeve të energjisë elektrike. ZRRE ka konstatuar se gjatë vitit 2026 pritet të ketë nevojë për sasi më të larta të energjisë së importuar, si rezultat i reduktimit të disponueshmërisë së prodhimit vendor gjatë periudhave të remonteve kapitale të njësive gjeneruese të KEK-ut.
- ZRRE përmes Raportin Konsultativ, ZRRE ka propozuar që kostoja e blerjes së energjisë me shumicë për Furnizuesin me Shërbim Universal për vitin 2026 të aprovohet në shumën prej 177.80 milion €, krahasuar me 229.04 milion € të propozuara në aplikacionin e FSHU-së. ZRRE ka vlerësuar se çmimet e propozuara për importin e energjisë dhe vëllimet e energjisë së importuar duhet të bazohen në projeksione të kujdesshme dhe të arsyeshme të tregut, duke reflektuar trendet aktuale të bursave rajonale dhe zhvillimet e pritshme në tregun e energjisë elektrike gjatë vitit 2026.
- ZRRE përmes Raportin Konsultativ ka vlerësuar gjithashtu se ndryshimet në kostot e blerjes së energjisë me shumicë ndikojnë drejtpërdrejt edhe në komponentët tjerë të HLM-së së FSHU-së, përfshirë marzhën me pakicë, lejimet për borxhin e keq dhe kapitalin punues, të cilat janë të ndërlidhura me nivelin e kostove të furnizimit me energji elektrike. ZRRE ka konstatuar se vetëm kostot reale, të arsyeshme dhe të justifikueshme të furnizimit duhet të reflektohen në tarifën e rregulluar për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e furnizimit universal.
- ZRRE gjatë vlerësimit të faktorëve korigjues të të hyrave ka konstatuar se rritja e kostove të furnizimit gjatë vitit 2025 ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së konsumit dhe importeve të energjisë elektrike për FSHU, si dhe nga prodhimi më i ulët vendor nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë krahasuar me parashikimet fillestare. ZRRE ka vlerësuar se konsumi për vitin 2025 ishte 351 GWh më i lartë se niveli i lejuar, importet për FSHU ishin 270 GWh më të larta se niveli i lejuar, ndërsa prodhimi nga BRE-të ishte 88 GWh më i ulët se niveli i parashikuar. Gjithashtu, ZRRE ka konstatuar se rritja e çmimeve të energjisë elektrike dhe kostove të kapaciteteve ndërkuftare kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kostove reale të furnizimit universal gjatë vitit 2025.



- ZRRE përmes Raportin Konsultativ , ka propozuar që faktori i përshtatjes së të hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal për vitin 2026 të aprovohet në shumën prej 48.30 milion €, krahasuar me 49.69 milion € të propozuara nga FSHU në aplikacionin e saj. ZRRE ka vlerësuar se ky korrigjim reflekton vetëm kostot reale, të arsyeshme dhe të justifikueshme të furnizimit universal dhe është i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë ndërmjet të hyrave të lejuara dhe kostove reale të realizuara gjatë vitit 2025.
- ZRRE po ashtu ka trajtuar zhvillimin e procesit të derregullimit të konsumatorëve që nuk janë të kualifikuar për Furnizim me Shërbim Universal, duke analizuar ndikimin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në strukturën e konsumatorëve të furnizuar nga FSHU dhe në kostot e përgjithshme të furnizimit universal. Në këtë drejtim, ZRRE ka vlerësuar se nga data 1 qershor 2025, konsumatorët që nuk përmbushin kriterin kumulativ të përcaktuar me Ligjin për Energjinë Elektrike nuk gëzojnë më të drejtën për furnizim universal dhe duhet të furnizohen në tregun e hapur të energjisë elektrike.
- ZRRE ka konstatuar se procesi i liberalizimit të tregut ka ndikuar në zvogëlimin e konsumit të energjisë elektrike të furnizuar nga FSHU dhe në ndryshimin e profilit të konsumatorëve që mbesin në furnizim universal. ZRRE ka vlerësuar se kostot e furnizimit universal për vitin 2026 duhet të reflektojnë vetëm kostot që ndërlidhen me konsumatorët që gëzojnë të drejtën e furnizimit universal, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike dhe interpretimin e Gjykatës Supreme lidhur me kriterin kumulativ për furnizim universal.
- ZRRE ka analizuar efektin e derregullimit të konsumatorëve dhe ndikimin e tij në vëllimet e energjisë elektrike që furnizohen nga FSHU, duke konstatuar se në tregun e lirë të energjisë elektrike operojnë gjithsej 9,535 pika matëse me konsum total prej 1,119.07 GWh gjatë vitit 2025, prej të cilave 95.00 GWh i përkasin konsumatorëve të kyçur në nivelin e transmisionit dhe 1,024.34 GWh konsumatorëve në rrjetin e shpërndarjes. ZRRE ka vlerësuar se këto zhvillime ndikojnë drejtpërdrejt në profilin e blerjeve të energjisë elektrike nga FSHU dhe në përlogaritjen e kostove të furnizimit universal për vitin 2026.
- ZRRE përmes Raportit Konsultativ ka vlerësuar se, pavarësisht shtyrjes së afatit për largimin e konsumatorëve jo-universal nga furnizimi i rregulluar deri më 1 maj 2026, kjo shtyrje nuk pengon konsumatorët e kualifikuar që të ushtrojnë të drejtën e tyre për furnizim në tregun e hapur të energjisë elektrike nga 01 prill 2026, në pajtim me procedurat dhe afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe rregullat e tregut. ZRRE ka konstatuar se pritet për kalimin e rreth 118 bizneseve në tregun e lirë gjatë vitit 2026 mbeten valide dhe janë marrë parasysh në përlogaritjen e profileve të furnizimit dhe sasive të energjisë elektrike për FSHU, ndërsa realizimi i tyre do të varet nga zhvillimet e mëtejshme të procesit të liberalizimit dhe vendimet përfundimtare rregullatore.
- ZRRE përmes Raportit Konsultativ ka trajtuar gjithashtu mekanizmin e profilizimit të kostove të furnizimit me energji elektrike për vitin 2026, duke propozuar shtyrjen e një pjese të kostove të blerjes së energjisë nga KEK-u për vitet e ardhshme tarifore. ZRRE ka vlerësuar se rreth 34 milion € të kostove të blerjes së energjisë elektrike janë profilizuar për rikuperim në vitet pasuese tarifore, me qëllim të zbutjes së ndikimit të menjëhershëm tarifor për konsumatorët gjatë vitit 2026. ZRRE ka theksuar se ky trajtim ka kontribuar në uljen e nivelit të MAR për vitin 2026, pa



përfaqësuar një reduktim real të kostove, ndërsa kostot e shtyra do të trajtohen në kuadër të shqyrtimeve të ardhshme tarifore në pajtim me kornizën rregullatore në fuqi.

- ZRRE përmes Raportit Konsultativ ka vlerësuar se, pas shqyrtimit të aplikacionit të Furnizuesit me Shërbim Universal, analizimit të Bilancit të përditësuar të Energjisë Elektrike, Raportit Konsultativ, komenteve të palëve të interesit dhe vlerësimeve të përfshira në Raportin Final për Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2026, ZRRE ka vlerësuar se të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal duhet të aprovohen në shumën prej 442.226 milion €. ZRRE ka konstatuar se kjo vlerë reflekton kostot reale, të arsyeshme dhe të justifikueshme për furnizimin e konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit universal, duke marrë parasysh zhvillimet në tregun e energjisë elektrike, ndikimin e liberalizimit të tregut, kostot e importeve të energjisë elektrike, kostot e bartshme nga operatorët e rregulluar dhe mekanizmat korrigjues të përcaktuar në metodologjitë tarifore në fuqi.
- ZRRE gjatë procesit të konsultimit publik për Raportin Konsultativ lidhur me Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal për vitin relevant tarifor 2026, ka pranuar komente dhe rekomandime nga Organizata e Shoqërisë Civile INDEP, si dhe nga të licencuarit KEDS, KESCO, KOSTT, KEK dhe Elektrosever. Komentet e paraqitura kanë trajtuar çështje që ndërlidhen me kostot e blerjes së energjisë me shumicë, kostot e importit të energjisë elektrike, çmimet e energjisë elektrike, profilizimin e kostove të furnizimit, faktorët korrigjues të të hyrave, kostot e bartshme dhe ndikimin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në furnizimin universal. ZRRE ka shqyrtuar të gjitha komentet dhe dëshmitë e paraqitura gjatë procesit konsultativ dhe ka vlerësuar secilin pretendim në përputhje me dispozitat e legjislacionit sektorial, metodologjitë tarifore dhe parimet e rregullimit ekonomik.
- ZRRE ka analizuar komentet e paraqitura nga KESCO/FSHU për kostot e blerjes së energjisë me shumicë dhe kostot e importeve, dhe ka vlerësuar të dhënat e përditësuara për realizimet e muajit mars 2026, Bilancin e përditësuar të Energjisë Elektrike dhe zhvillimet në tregun rajonal të energjisë elektrike, ku në Raportin Final ka përditësuar kostot e blerjes së energjisë me shumicë nga 177.801 milion € të propozuara në Raportin Konsultativ në 176.310 milion €, duke reflektuar kostot reale të realizuara dhe çmimet e përditësuara të energjisë elektrike për pjesën e mbetur të vitit 2026.
- Po ashtu në raport me komentet e paraqitura lidhur me kostot e bartshme nga operatorët e rregulluar, ZRRE ka vlerësuar se këto kosto duhet të përditësohen në përputhje me vendimet përfundimtare për të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT dhe OSSH për vitin tarifor 2026. Në këtë drejtim, në Raportin Final janë reflektuar kostot e bartshme për OST/OT në shumën prej 31.644 milion €, kostot e OSSH-së në shumën prej 158.473 milion € dhe kostot e Fondit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë në shumën prej 8.724 milion €.
- ZRRE lidhur me komentet e paraqitura nga palët e interesit për profilizimin e kostove të furnizimit dhe ndikimin e tyre në tarifat e energjisë elektrike për vitin 2026, ka analizuar efektet financiare të rritjes së importeve të energjisë elektrike, rehabilitimit të planifikuar të njësive gjeneruese Kosova A dhe Kosova B, si dhe ndikimin e këtyre zhvillimeve në kostot e furnizimit universal, dhe ka vlerësuar se aplikimi i mekanizmit të profilizimit të një pjese të kostove të furnizimit është i nevojshëm për të zbutur ndikimin e menjëhershëm tarifor për konsumatorët fundorë gjatë vitit



2026, duke ruajtur njëkohësisht stabilitetin financiar të Furnizuesit me Shërbim Universal dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

- ZRRE konstaton se KEK Sh.A. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU/KESCO Sh.A.) kanë arritur Marrëveshje për Riprogramimin e Borxhit lidhur me faturat e periudhës janar – mars 2026, përkatësisht faturat nr. 1008904, 1009081 dhe 1009284, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit tarifor dhe shmangies së bartjes së menjëhershme të këtyre kostove tek konsumatorët fundorë gjatë vitit 2026. ZRRE ka vlerësuar se kjo marrëveshje përfaqëson mekanizëm legjitim të profilizimit të kostove të furnizimit dhe se kostot dhe obligimet financiare që rezultojnë nga kjo marrëveshje, përfshirë principalin, interesin e riprogramuar dhe kostot tjera të paraqitura në aneksin e marrëveshjes, pjesë e pandarë e saj, do të trajtohen si kosto të arsyeshme në kuadër të shqyrtimit të ardhshëm tarifor, në pajtim me realizimet financiare, legjislacionin dhe metodologjitë rregullatore në fuqi.
- ZRRE gjatë shqyrtimit të komenteve të INDEP lidhur me nivelin e kostove të furnizimit, ndikimin e importeve dhe procesin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, ka vlerësuar se metodologjia e aplikuar për përcaktimin e kostove të lejuara është bazuar në të dhënat më të fundit reale të disponueshme, Bilancin e përditësuar të Energjisë Elektrike dhe zhvillimet aktuale të tregut të energjisë elektrike. Gjithashtu, ZRRE ka theksuar se përlllogaritjet tarifore për vitin 2026 reflektojnë vetëm kostot reale, të arsyeshme dhe të justifikueshme të furnizimit universal dhe janë bërë në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe ruajtjes së stabilitetit të sistemit elektroenergetik.
- ZRRE pas shqyrtimit të aplikacionit të Furnizuesit me Shërbim Universal, Raportit Konsultativ, komenteve të palëve të interesit dhe vlerësimeve të përfshira në Raportin Final për Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2026, ka vlerësuar se të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal duhet të aprovohen në shumën prej 442,228,632 €, duke konsideruar se kjo vlerë siguron mbulimin e kostove reale, të arsyeshme për furnizimin e konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit universal në Republikën e Kosovës.
- Andaj të Hyrat Maksimale të Lejuara që do të mblidhen nga FSHU, për vitin 2026 do të jenë në shumën prej 442,228,632 €, ashtu siç është vendosur edhe në dispozitiv të këtij Vendimi.
- FSHU bazuar në pikën III. të dispozitivit të Vendimin V_3213_2026 të datës 05 maj 2026 është obliguar t'i përgatisë dhe dorëzojë në ZRRE propozimin për aprovim të tarifave të rregulluara me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal.
- ZRRE më datë 06 maj 2026 ka pranuar nga FSHU propozimin për Tarifat me Pakicë të Energjisë Elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal.
- ZRRE sa i përket propozimit të FSHU/KESCO Sh.A. për ndryshimin strukturor të dizajnit tarifor, përkatësisht eliminimin e diferencimit ditë/natë dhe bllok tarifës, ka vlerësuar se një ndryshim i tillë nuk mund të trajtohet në kuadër të këtij procesi të aprovimit të tarifave vjetore, pasi tejkalon karakterin teknik të përshtatjes së tarifave sipas HLM-së së aprovuar. Ndryshimi i strukturës tarifore kërkon analizë të detajuar të ndikimit në kategori të ndryshme të konsumatorëve, vlerësim të efekteve në sjelljen e konsumit dhe në ngarkesën e sistemit, si dhe konsultim publik të veçantë me palët e interesit. Për këtë arsye, propozimi për ndryshim të strukturës tarifore nuk është marrë parasysh me këtë vendim.



- ZRRE ka shqyrtuar dhe vlerësuar tarifat e Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU) janë në përputhje me Metodologjinë për Strukturën Tarifore dhe Nenin 20 të Rregullës ZRRE/Nr.15/2017 për të Hyrat e FSHU-së. Tarifat e vlerësuara nga ZRRE bazohen në vendimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU, V_3213_2026 të datës 05 maj 2026.
- ZRRE ka vlerësuar se tarifat e propozuara nga FSHU, reflektojnë kostot e shërbimit të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit Universal.
- ZRRE ka vlerësuar se tarifat me pakicë për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal të përcaktuara nga ZRRE, reflektojnë kostot e përgjithshme të furnizimit të konsumatorëve me të drejtën e Furnizimit të Shërbimit Universal, ku përfshihen kostot e energjisë elektrike me shumicë, kostot e rrjetit të transmisionit dhe shpërndarjes dhe kostot direkte të FSHU-së.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të propozimit për Tarifat e Furnizuesit me Shërbim Universal, ka vlerësuar se kërkesa është e bazuar në Vendimin V_3213_2026 të datës 05 maj 2026 për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar


Arta Isufi, anëtare


Adnan Prehiqi, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO,
- KEDS,
- KOSTT dhe
- Arkivit të ZRRE-së.